



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 1541/1 Prot.

Vlorë, më 17.12.2018

VENDIM

Nr. 83, datë 17.12.2018

PËR MIRATIMIN E KERKESAVE TË STUDENTËVE PROTESTUES

Në mbështetje të nenit 38 të Ligjit Nr. 80/ 2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.12.2018:

VENDOSI:

1. Të pranojë dhe të vlerësojë si të drejta, racionale dhe konstruktive 5 kërkesat e paraqitura nga studentët protestues të UV dhe t'i inkurajojë ata që dialogun e nisur me Rektoren, Rektoratin dhe SA ta vijojnë edhe në të ardhmen, me qëllim përfshirjen e tyre aktive në bashkëqeverisje të institucionit dhe përsosjen e marrëdhënieve mes tyre dhe personelit akademik/ndihmësakademik dhe administrativ, organeve dhe autoriteteve drejtuese, në funksion të një jete universitare cilësore, korrekte, etike dhe efikase.
2. Të sigurojë gjithë studentët e UV-se se protesta që ata zhvillojnë është një e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme e tyre dhe për këtë jo vetëm nuk do të penalizohen në asnjë rast, në asnjë formë dhe nga asnjë faktor brenda dhe jashtë institucionit, por t'iu jepen të gjitha ndihmat dhe akseset ligjore për mësim, konsultim, provime të pjesshme etj. Të evidentohet dhe penalizohet çdo pedagog i cili verifikohet se diskriminon, pengon dhe ndalon studentet që të marrin pjesë në protestë.
3. Të finalizojë punën e filluar për krijimin e Këshillit Studentor në UV. Të përfundojë dhe të miratohet sa më shpejt Rregullorja e Këshillit Studentor dhe Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ) të kryejë të gjitha detyrimet që i ngarkon ligji në funksion të një procesi zgjedhor studentor të drejtë, të barabartë, asnjans dhe demokratik.
4. Me zgjedhjen e Këshillit Studentor, propozimi i studentëve, për pragun e pranimit të studenteve në Universitetin e Vlorës, për nxënësit maturantë, do të jetë objekt i konsultimit me të gjithë strukturat kompetente të UV-së si dhe grupet e interesit, përpara se t'i përcillet Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sporteve, përpara se të vendosen kriteret shtesë të pranimit.
5. Të mbështesë në praktikë, përmes buxhetit të vitit 2019, kërkesën për pajisjen me laboratorë në ato programe studimi, të cilat ende nuk janë pajisur, siç është rasti i Shkencave Elektrike etj. T'i propozojë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë që të bëjë propozimet për ndryshimet e kuadrit ligjor në fuqi për mbulimin e shpenzimeve të transportit për praktikantët e studentëve jashtë Vlorës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Të falenderojë gjithë studentet e Universitetit të Vlorës për solidaritetin e treguar me personelin akademik në deklaratën e tyre, në të cilën thuhet se: *"Studentët e Vlorës të cilët kanë marrë pjesë në protestat të cilat janë zhvilluar gjatë kësaj periudhe kohore, nuk kanë lidhje me emrat e pedagogëve të cilët kanë dalë nëpër rrjetet sociale dhe janë akuzuar për korrupsion"*.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen zv/rektorët, dekanatet, administratori i UV-së, drejtorët e drejtorive në rektorat.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Roland ZISI

